



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë, 30.6.2022

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 5.7.2022, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër nr. 256, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Etleva Deda.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik, kundër vendimit nr.256/2020, të Komisionit, për efekt të këtij gjykimi, Komisioneri Publik parashtron sa në vijim:

1. *Pasuria "Apartament me sip. 115 m²", ndodhur në rrugën " *** **", Tiranë.*

1.1 Në D-Vett., nga subjekti i rivlerësimit deklarohet [...]Më **10.2009 kam lidhur me shoqërinë " *** " sh.p.k. kontratën e porosisë me nr. *** rep./ *** kol., ku kam porositur ndërtimin e një apartamenti banimi me sip.115 m², në katin e pestë të banimit, në rrugën " *** **", Tiranë. Vlera e përgjithshme e apartamentit është 92.000 euro, 800 euro/ m², nga të cilat 72.000 euro janë likuiduar me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes dhe 20.000 euro do likuidohen me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes. Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep./ *** kol., datë **12.2011, nga shoqëria " *** " sh.p.k., kam blerë një apartament banimi nr. 26, me sip.107,5 m², në vlerën 92.000 euro. Pjesa takuese: 100%[...].

1.2 Si burime krijimi për pasurinë apartament me sip.115 m², të trajtuara për efekt të shkaqeve të ankimit të datës 11.8.2020, subjekti ndër të tjera¹, ka deklaruar (i) kredi në shumën 5.000.000

¹ Po ashtu subjekti ka deklaruar si burime të tjera: (iv) Pjesa takuese prej 250.000 lekë (1/4) nga shitja e njësisë së shërbimit (dyqan) me sip. 26,15 m², me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **12.2007; (v) Pjesa takuese prej 13.750 euro (1/4) nga shitja e njësisë së shërbimit (dyqan) me sip. 47.7 m² sipas kontratës së shitblerjes me rezervë me afat me nr. *** rep, nr. *** kol, datë **7.2013; (vi) Dhuratë nga babai z. ***. në shumën prej 4.000 euro; (vii) hua në shumën 8.000 euro nga shtetasia *** (vjehera e xhaxhait), sipas kontratës së huasë me nr. *** rep, nr. *** kol, datë **11.2011.

lekë pranë *** Bank, sipas Kontratës së Kredisë me nr. *** rep./ *** kol., datë ** .9.2006; (ii) të ardhura nga paga, të siguruara nga puna, ndër vite; (iii) dhuratë nga prindërit z ** . dhe *** në muajin tetor të vitit 2009 në shumën prej 15.000 euro².

1.3 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë si më sipër, pa specifikuar burimin e krijimit duke deklaruar se [...] *Kam likuiduar këstin e parë 72.000 euro dhe këstin e dytë 20.000 euro do e likuidoje me kryerjen e aktit të shitblerjes*". Pjesa takuese: 100% [...].

1.4 Në DV-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e këstit të dytë prej 20.000 euro më datë **.11.2011 dhe regjistrimin e pasurisë në Z.R.P.P., më datë **.12.2011. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për shlyerjen e shumës 20.000 euro.

1.5 Në vijim, gjejnë pasqyrim çështjet e konstatuara lidhur me burimet e deklaruara:

1.6 (i) *Kredi e marrë nga *** Bank në vitin 2006, në shumën prej 5.000.000 lekë, me afat 14 vjet*³, deklaruar për herë të parë nga subjekti në DV-2006. Në deklaratat periodike vjetore pasardhëse deri në fund të vitit 2016, në vijimësi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen vjetore të kredisë, si dhe detyrimin e mbetur në fund të vitit.

1.6.1 Referuar lëvizjeve të llogarive bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, të administruara në dosje të Komisionit, rezulton se janë kryer transaksionet vijuese (i) më datë **.9.2006, në llogarinë e pagës së subjekti të rivlerësimit pranë *** , është disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë, shumë e cila rezulton të jetë tërhequr *cash* nga subjekti në datë **.11.2006; (ii) po në datë **.11.2006, kjo shumë është depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë e saj rrjedhëse pranë *** Bank; (iii) më datë **.2.2007, nga kjo llogari në *** bank, subjekti ka tërhequr *cash*, shumën prej 2.500.000 lekë dhe më datë **.2.2007, ka tërhequr *cash* shumën prej 1.000.000 lekë; (iv) më datë **.4.2007, kjo llogari është kredituar me shumën prej 2.500.000 lekë, nga një transfertë e brendshme; (v) më datë **.4.2007, subjekti ka tërhequr *cash* nga kjo llogari, shumën 2.000.000 lekë dhe më datë **.4.2007, ka tërhequr shumën 2.000.000 lekë, duke zëruar llogarinë pranë *** bank.

1.6.2 Subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton të ketë deklaruar në DV-2006 llogarinë bankare në *** bank, me burim kredinë në vlerën 5.000.000 lekë, si dhe në DV-2007 dhe DV-2008 nuk ka deklaruar posedimin e likuiditeteve *cash*, të tërhequra gjatë vitit 2007.

1.6.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me (a) arsyen e distancës kohore mbi tre vjet, nga marrja e kredisë deri në datën e blerjes së apartamentit; (b) përdorimin e shumës 5.000.000 lekë, të tërhequra *cash* nga llogaria bankare në *** në datë **.11.2006; (c) burimin, arsyen e kryerjes së transaksioneve dhe përdorimin e shumave të tërhequra nga llogaria bankare në *** Bank, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se [...] *Shumën e kredisë të akorduar nga *** e kam*

² Sipas Deklaratës Noteriale nr. *** rep./ kol., datë **.4.2011, konvertuar në 2.057.550 lekë, bazuar në kursin zyrtar të BSH për vitin 2009

³ Konfirmuar nga *** Bank me shkresën nr. *** , datë **.2.2019. Për sigurimin e kredisë, nga ana e subjektit të rivlerësimit është lënë garanci hipotekore një apartament me sip.144 m², i ndodhur në Durrës, në pronësi të z. *** dhe bashkëshortes së tij, znj. *** (tezja dhe bashkëshorti i tezes së subjektit të rivlerësimit).



tërhequr në datë **11.2006. Në kushtet kur në momentin e marrjes (tërheqjes) së kredisë, nuk më ishte krijuar mundësia për t'a përdorur për blerjen e një apartamenti, për qëllim ruatje e kam kredituar tek *** Bank ⁴...shumën e kam zeruar më datë **4.2007., duke e mbajtur gjendje cash, deri në momentin që kam paguar këstin e parë për blerjen e apartamentit[...].

1.6.4 Subjekti i rivlerësimit në komunikimet elektronike me ILDKPKI, të administruara në dosje të Komisionit, lidhur me pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament me sip.115 m², ndër të tjera, po ashtu ka deklaruar se [...]Në këstin e parë përfshihet kredia e marrë për këtë qëllim në v. 2006, e cila është konvertuar nga lekë në euro dhe anasjelltas në varësi të kursit të këmbimit valutor, duke qenë se e disponoja në cash[...].

1.6.5 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se [...]Subjekti nuk ka deklaruar (dëpv) lidhur me destinacion e shumës së tërhequr në vitin 2007 dhe as gjendje cash në shtëpi përkatësisht në vite 2007 – 2008 duke mbetur kështu i paqartë burimi i të ardhurave në shumën 5.000.000 përdorur në vitin 2009 për blerjen e apartamentit[...].

1.6.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar [...]...duke qenë se kredinë bankare e kam deklaruar në Deklaratat e Interesave Private Periodike/Vjetore (nga viti 2006 e në vazhdim)...pavarësisht se shumën e kredisë e kam patur gjendje cash në banesë deri në vitin 2009, e kam vlerësuar si fakt të deklaruar...Mosdeklarimi i gjendjes cash në fund të vitit 2007 ka qenë një pasaktësi e paqëllimshme...[...].

1.6.7 Në përfundim, Komisioni, në konsideratë të deklarimeve të subjektit, në vendimin e tij ka arsyetuar se [...]Pasaktësitë në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2008, lidhur me pasqyrimin e gjendjes cash në banesë të shumës së marrë me kredi, nuk mund të konsiderohen si të tilla që të ngrenë dyshime mbi ekzistencën apo ligjshmërinë e këtij burimi, për sa kohë provohej se ajo shumë e disbursuar prej *** Bank në vitin 2006, është transferuar në *** Bank dhe tërhequr cash nga subjekti në vitin 2007, disponohej në fund të atij viti pasi nuk rezulton e shpenzuar as në deklarimet periodike dhe as gjatë hetimit administrativ të Komisionit. Po ashtu, subjekti e ka deklaruar këtë shumë si detyrim, nëpërmjet deklaratave periodike vjetore dhe të përdorur si burim për blerje apartamenti në vitin 2009 [...] ⁵.

1.6.8 Komisioneri Publik, konstaton se ky konkluzion i Komisionit, referuar interpretimit gjyqësor të pasqyruar në jurisprudencën e Kolegjit⁶, nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e deklarimeve të interesave private periodik/vjetor të subjektit të rivlerësimit, referuar vlerës e tyre provuese për verifikimin e gjendjes së cash-it jashtë sistemit bankar, duke afektuar verifikimin e këtij burimi të deklaruar për krijimin e pronësisë së apartamentit të banimit.

⁴ Gjithashtu subjekti ka deklaruar se shumën prej 2.500.000 lekë të tërhequr nga llogaria në datë **2.2007, ia ka dhënë hua shtetasit *** , i cili ia ka kthyer në datë **4.2007, veprim që konfirmohet me deklaratën noteriale nr. *** rep dhe *** kol., në datë **11.2009.

⁵ Referohuni vendimit të Komisionit prg. 109, fq 27.

⁶ Referohuni, ndër të tjera, në vendimin (JR) nr.7/2019, (JR) nr.11/2019, (JR) nr.19/2019, (JR) nr.33/2020], (JR) 13/202, etj.

1.6.9 Në të tilla rrethana fakti dhe ligjore, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së kështit të parë të pasurisë apartament me sip.115 m², sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

1.2 *Lidhur me burimin e deklaruar: (ii) Të ardhura nga paga të siguruara nga puna ndër vite*, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodik/vjetor, në vitet 2006 deri në 2010, ka deklaruar kursime nga pagat në *cash (janar deri në dhjetor)*⁷, të cilat, në deklaratën Vetting, janë deklaruar si burim për pasurinë apartament me sip.115 m². Nga aktet në dosje, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pakësim të kursimeve *cash*, në DV- 2009, kur është kryer pagesa në shumën 72.000 euro për kështin e parë të apartamentit në datë **.10.2009 dhe në DV-2011, kur është kryer pagesa e kështit të dytë në shumën 20.000 euro, në datë **.11.2011.

1.2.1 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...] *kursimet nga paga të siguruara prej meje deri në vitin 2009 (duke përfshirë dhe kursimet e atij viti), i kam zeruar në vitin 2009 për pagimin e kështit të parë të blerjes së apartamentit në pronësinë time[...]*.

1.2.2 Komisioni, në përfundim të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës duke konstatuar se [...] *Subjekti ka deklaruar se ka përdorur në vitin 2009 shuma të kursimeve të saj cash nga paga, si burim për blerjen e apartamentit, ndërkohë që i ka deklaruar ato edhe si gjendje cash në fund të vitit 2009[...]*⁸.

1.2.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, duke i qëndruar pretendimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se [...] *për pagesën e shumës 72.000 euro në datë **.10.2009, kanë shërbyer edhe kursimet nga pagat ndër vite deri në vitin 2009 (gjendje cash) në shumën 2.050.000 lekë[...]*.

1.2.4 Komisioni, në vendim ka arsyetuar se [...] *megjithëse i gjen deklaramet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen cash dhe përdorimin e tyre, jo në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, në përfundim vlerëson se ato janë pasaktësi të paqëllimshme dhe se deklaramet e subjektit në deklaratën “Vetting” ndihmojnë për të kuptuar drejt deklaramet e tij[...]*.

1.2.5 Komisioneri Publik, ashtu sikurse ka trajtuar në ankimin e datës 11.8.2020, referuar jurisprudencës së Kolegjit, ka në konsideratë faktin se dispozitat kushtetuese dhe ligjore për

⁷ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) në DV-2006: *kursime nga paga për periudhën e punës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda deri në dhjetor të vitit 2006*, në shumën 1.000.000 lekë; (ii) në DV-2007: *“kursime nga paga për periudhën...nga janari deri në 31 dhjetor të vitit 2007”*, në vlerën 350.000 lekë; (iii) në DV-2008: *“kursime nga paga për periudhën ... nga janari deri në dhjetor 2008”* në vlerën 300.000 lekë; në DV-2009: *“kursime nga paga për periudhën ... nga janari deri në dhjetor 2009”* në vlerën 400.000 lekë; në DV-2010: *“kursime nga paga për periudhën ... nga janari deri në dhjetor 2010”* në vlerën 500.000 lekë.

⁸ Referohumi fq.16, të rezultateve të hetimit, në dosje të Komisionit.

procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit.

1.2.6 Lidhur me deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, Komisioneri Publik, vëren se Kolegji në jurisprudencën e tij ka orientuar Komisionin që të mos [...]presumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike⁹[...].

1.2.7 Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik, pa prezumuar përdorimin e cashit të akumuluar deri në fund të vitit 2008, konstaton se subjekti i rivlerësimit me të ardhurat nga paga për periudhën deri më **10.2009, datë në të cilën është kryer pagesa e këstit të parë të apartamentit, kishte mundësi të kursente shumën prej 600.623 lekë¹⁰.

1.2.8 Në përfundim, lidhur burimin e deklaruar “të ardhura nga paga të siguruara nga puna”, për krijimin e pasurisë apartament me sip. banimi 115 m², konstatohet se, në kuptim të nenit D, pika 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm¹¹.

1.3 Lidhur me burimin e deklaruar: (iii) Dhuratë nga prindërit në shumën 15.000 euro (ose 2.057.550 lekë), në vitin 2009, deklaruar si një nga burimet e pasurisë apartament me sip.115 m².

1.3.1 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale” ka deklaruar [...]dhuratë nga prindërit ***. dhe ***, në vlerën 15.000 euro. Pa akt noterial, pasi gëzojmë marrëdhënie të posaçme[...].

1.3.2 Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur D-Vett. ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep./*** kol., datë **4.2011¹², në të cilën prindërit e subjektit të rivlerësimit, z. *** dhe znj. ***, deklarojnë se [...]në tetor të vitit 2009 i kanë dhuruar vajzës së tyre Etleva Deda shumën prej 15.000 euro, për blerjen e ap. në Tiranë, rr. “ *** ”. Shtetasi *** deklaroi se, me datë **12.2006, i ka shitur shtetasit. *** . ap. 3+1, ndodhur në katin e 5 (pestë) të ndërtimit, kundrejt çmimit prej 9.000.000 lekë, të reja. *** . deklaroi gjithashtu se, me datë **12.2006, ka blerë një ap. 2+1 në katin e 9-të, ku vlera e blerjes është 5.300.000 lekë të reja. Deklarojmë se shuma

⁹ Referuar prgr.39, të vendimit (JR) nr.7/2019 të Kolegjit.

¹⁰ Duke përlogaritur tërheqjet cash nga llogaria e pagës në shumën 760.000 lekë, shpenzimet e jetesës 113.850 lekë dhe shpenzimet e udhëtimit 45.527 lekë. Bazuar në deklaratimet e kursimeve cash duke filluar nga viti 2006, rezultoi se deri në fund të vitit 2008, subjekti ka pasur kursime cash të deklaruara dhe të justifikuara, shumën prej 1.399.001 lekë, shumë e cila nuk rezultoi të jetë deklaruar si pakësim në vitin 2009.

¹¹ Edhe sikur të konsiderojmë të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi përdorimin e kurimeve cash të deklaruara, sërish subjekti do rezultonte me një pamjaftueshmëri në shumën 376.843 lekë, në datën **10.2009. Po ashtu, për periudhën **10.2009 deri në 31.12.2009, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme kursimin e deklaruar në shumën 400.000 lekë, për një diferencë negative në shumën -252.770 lekë. Nëse kësaj difference i shtojmë rezultatin e analizuar për periudhën **1.2009 -**10.2009, diferenca negative e vitit 2009 rezultoi në shumën prej -629.613 lekësh.

¹² Nga aktet rezultoi se subjekti e ka paraqitur këtë deklaratë dhe në ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur për të dokumentuar shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, që mban datën ** prill 2011.



prej 15.000 eurosh buron nga diferenca e vlerës së shitjes së ap. të parë dhe vlerës së blerjes së ap. të dytë[...].

1.3.3 Komisioneri Publik, vlerëson të nënvizojë evoluimin e jurisprudencës së Kolegjit lidhur mesa kërkuar, si një nga shkaqet e parashtruara nga Komisioneri Publik në prgr.22 e vijues në ankimin e datës 11.8.2020, për verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

1.3.4 Duket se Kolegji, në një vendim të mëvonshëm nga koha e paraqitjes së ankimit konkret, mbi kërkimin e Komisionerit Publik për orientimin e praktikës gjatë gjykimit të ankimit të paraqitur për një tjetër subjekt rivlerësimit, tashmë ka interpretuar lidhur me verifikimin e burimit dhe ligjshmërinë e shumave monetare të dhuruara, parë kjo e fundit në raport me pagimin e tatimit për to¹³.

2. Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur nësa parashtrohet mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerëson se deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke se nuk përmbushin kërkesat e nenit D, paragrafi 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe e klasifikojnë subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

II. Kërkimi i ankimit

3. Nisur nga dispozitat e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, referuar sa ka disponuar Komisioni në rastin konkret, në gjendjen që janë faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, në zbatim të jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

4. Bazuar në kërkesat e neneve D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkujmë që shkaqet parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

KOMISIONERI PUBLIK



FLORIAN BALLHYSA

¹³ Vendim (JR) nr.15/2021, prg.23.12 dhe prg.23.13.